



Agjencia e Punësimit (AP) në suaza të projektit ekzistues të financuar nga BE-ja “Mbështetja për punësimin e të rinjve, të papunëve afatgjatë dhe grave” (II), bën:

### **Shpallje publike**

#### **për personat e papunë afatgjatë për pjesëmarrje në “Stërvitjen për aftësitë e kërkuara në tregun e punës”**

U bëhet thirrje të gjitha të papunëve afatgjatë të evidentuar në Agjencinë e Punësimit si kërkues aktiv të punës, që të shprehin interesim dhe të apalikojnë në një rën nga profesionet fundamentale të theksuara në listë dhe të marrin pjesë në stërvitjet për fitimin e njohurive plotësuese dhe aftësive profesionale të cilat janë të kërkuara në tregun e punës. Këto stërvitje do ta rrisin punësimin e 220 personave të papunë dhe do të sigurojnë mundësi për rritjen e shkathtësive profesionale dhe marrjen e kualifikimeve për profesionet specifike të kërkuara në tregun e punës.

Të gjithë të papunët afatgjatë të evidentuar në Agjencinë e Punësimit si kërkues aktiv të punës, mund të paraqiten për ndonjërin nga profesionet e listës:

- Gatues
- Kamarier
- Shitës
- Punëtor ndërtimtarie për rinovimin e shtëpive tradicionale
- Fasadist
- Ëmbëltorist
- Gatues i bukës dhe prodhimeve të brumit
- Saldues me argon
- Montues dhe instalues i paneleve diellore
- Nëpunës i kontabilitetit
- Nëpunës i agjencive turistike
- Masazhist
- Makijazhist
- Pedikyr/Manikyr
- Kozmetist
- Filigranist
- Përpunues i stolive të arta
- Asistent për përkujdesjen e pleqve në kushte shtëpiake
- OXHAKFSHIRËS
- Mjeshtër shtëpiak





## Support to the Employment of Young People, Long-Term Unemployed and Women (II)

This project is funded by the European Union



Stërvitjet do të mbahen në një periudhë prej katër muajsh. Stërvitjet përfshijnë ligjërata, orë përgatitore për provim dhe provimet për marrjen e certifikatës.

Çdo person i papunë që zgjidhet për të marrë pjesë në stërvitje do të nënshkruajë marrëveshje për pjesëmarrje në stërvitjen për të cilën ka aplikuar.

Gjatë kohës së stërvitjes, Agjencia e Punësimit do t'i mbulojë shpenzimet mujore (harxhimet e ushqimit dhe udhëtimit) për pjesëmarrësit në stërvitje në shumën prej 6.236,00 denarë, duke përfshirë sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe tatimin personal për të ardhurat për secilin pjesëmarrës, në përputhje me legjislativin nacional.

Personat e papunë të cilët do të mbarojnë së paku 70 për qind të programit të stërvitjes (orëve të stërvitjes) do të mund ta japin provimin për marrjen e certifikatës.

### Kriteret e aplikimit:

Të papunët afatgjatë që janë të interesuar mund ta plotësojnë aplikimin e pjesëmarrjes me qëllim që ta shprehin interesimin e pjesëmarrjes në njërin nga stërvitjet e lartpërmendura në Agjencinë e Punësimit dhe në ndonjërin nga qendrat e punësimit brenda shtetit.

Kandidatët do të parazgjidhen nga baza e kërkuesve aktiv të punës ku janë të regjistruar në Agjencinë e Punësimit, në përputhje me deklaratën e tyre në planin individual të punësimit (PIP). Kandidatët e parazgjedhur do të thirren (nëpërmjet SMS-së ose emailit) në qendrat e punësimit për ta plotësuar aplikimin e pjesëmarrjes dhe për të zgjedhur stërvitjen që u intereson më së shumti.

Të gjithë të papunët afatgjatë si kandidatë duhet t'i plotësojnë kriteret siç vijojnë:

- Të papunët afatgjatë të regjistruar në Agjencinë e Punësimit si kërkues aktiv të punës më tepër se një vit;
- Deklaratë në planin individual të punësimit (PIP), nëse e ka plotësuar;
- Arsimimin adekuat, aty ku është relevante, varësisht nga lloji i stërvitjes që e ka zgjedhur.

Përzgjedhja përfundimtare e pjesëmarrësve do të bëhet nga ana e komisionit të evaluimit në bazë të kriterëve të lartpërmendura, duke formuar listën e rangimit të kandidatëve të interesuar për të marrë pjesë në stërvitjet për shkathtësitë e kërkuesve në tregun e punës të cilat planifikohen të organizohen në periudhën e ardhshme.

Nëse numri i pjesëmarrësve të interesuar e kalon numrin e planifikuar të kandidatëve për stërvitjet e caktuara, atëherë do të zbatohen kriteret plotësuese për përzgjedhje të cilat bashkëngjitur me numrin e viteve të regjistrimit të personit si i papunë në Agjencinë e Punësimit, do t'i përfshijnë edhe parimet siç vijojnë, si kriteret plotësuese në përzgjedhje:

- Kandidatët të cilët tanimë kanë marrë pjesë në ndonjë stërvitje të caktuar për shkathtësitë e kërkuesve në tregun e punës, nuk mund të përfshihen sërish në stërvitje;
- Nëse kandidatët kanë arsimim të ngjashëm për atë që mbahet stërvitja, atëherë do të merret parasysh si përparësi gjatë përzgjedhjes;





**Support to the Employment of Young People,  
Long-Term Unemployed and Women (II)**



**This project is funded by the European Union**

- Nëse numri i kandidatëve të përshtatshëm është më i madh sesa ai i planifikuari për pjesëmarrje në stërvitje, atëherë kandidatët do të zgjidhen sipas kualifikimit në listën e rangimit të kandidatëve.

### **Procedura dhe afati i aplikimit**

Agjencia e Punësimit i inkurajon të gjithë të papunët afatgjatë që të plotësojnë aplikimin për pjesëmarrje në ndonjërën nga stërvitjet për profesionet e lartpërmendura në Agjenciën e Punësimit dhe në ndonjërën nga 30 qendrat e punësimit brenda shtetit, duke theksuar tipin e stërvitjes, çdo ditë prej orës 8:30 deri 16:30.

Të gjitha të dhënat e përfshira në fletëparaqitjen e pjesëmarrjes do të trajtohen në mënyrë sekrete.

Informata të hollësishme mund të merren në klubet e 30 qendrave të punësimit ku pesonat janë të evidentuar si të papunë, si dhe në telefonin kontaktues (02) 3 213 070 dhe ueb faqen e Agjencisë së Punësimit [www.avrm.gov.mk](http://www.avrm.gov.mk).

Shpallja publike do të botohet në ueb faqet siç vijojnë:

- Agjencia e Punësimit [www.avrm.gov.mk](http://www.avrm.gov.mk)
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk).

Projekti “Mbështetja për punësimin e të rinjve, të papunëve afatgjatë dhe grave” (II) është financuar në suaza të programit operativ për “Zhvillimin e burimeve njerëzore 2007-2013) (IPA Komponenti IV). Aktivitetet e projektit ndihmojnë drejtpërdrejt në arritjen e qëllimeve nga plani operativ i masave aktive në tregun e punës për vitin 2015.

